



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Nenit 16 të ligjit nr.08/L-066. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës 03.06.2022 me 01Nr.401-18729 si dhe me rekomandimin e KPF-së datë 13.06.2022, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2022, të mbajtur me datën 24.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për transferimin e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e shpenzimeve kapitale për Komunën e Klinës.

2. Transferi i mjeteve bëhet nga kategoria Rezerva (kodi -38) në kategorinë ekonomike Shpenzime kapitale (kodit -300), fondi 10 si në vijim:

Nga nën programet:

Inspektimet (16635), shuma prej 5,000 €.

Bujqësia (47018), shuma prej 10,000 €.

Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), shuma prej 35,000 €.

Transferohen në kategorinë e shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (10).

Në nën programet:

-Inspektimet (16635), në projektin "She njëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve " kodit i projektit (47933), shuma prej 5,000 €,

-Bujqësia (47018), projektin "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes " kodit i projektit (48004), shuma prej 10,000 €.

-Planifikimi urban dhe Inspeksioni (66395), në projektin: Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Qeskovë" kodit i projektit (51445), shuma prej 35,000 €,

-Transfer i mjeteve nga kategoria Rezerva (kodi -38) në kategorinë ekonomike Shpenzime kapitale (kodit -300), fondi 21

Nga nën programet:

Inspektimet (16635), shuma prej 15,000 €,

Buxhetimi (17518), shuma prej 40,000 €,

Bujqësia (47018), shuma prej 20,000 €,

Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), shuma prej 40,000 €.

Transferohen në kategorinë e shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21)

Në nën programet:

-Inspektimet (16635), në projektin "Shënjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve " kodit i projektit (47933, shuma prej 15,000 €.

-Buxhetimi (17518), në projektin “Fondi për eksproprijim” kod i projektit (47948), shuma prej 40,000 €,

-Bujqësia (47018), në projektin “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes “ kod i projektit (48004), shuma prej 20,000 €,

Planifikimi urban dhe Inspeksioni (66395), ne projektet: “Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Qeskovë” kod i projektit (51445), shuma 15,000 €, “Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë” kod i projektit (48095), shuma 25,000 €

3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Arsyetim:

Transferimi i mjeteve rezervë në projektet e mësipërme bëhet me qëllim të rritjes së buxhetit për këto projekte pas rritjes së çmimeve. Vlera e buxhetit për këto projekte nuk është i mjaftueshëm për realizimin e tyre pas rritjes së çmimeve. Procedurat e prokurimit për këto projekte nuk kanë filluar ende. Për shkak të rritjes së çmimeve për disa kontrata operatorët i kanë ndërprerë punimet.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtorja për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-2240 /22
Klinë, me 29.06 /22



Kryesuesi,
Fadil Gashi